



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 101 Prot

Tiranë, më 15.10. 2007

VENDIM Nr. 18 dt. 11.10.2007

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 11.10.2007, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

- a) Të përfundojë Zonifikimi i qytetit të Durrësit nga IA, DAD, i shoqëruar me relacionin përkatës.
- b) Të përfundojë rregullorja e ruajtjes dhe administrimit të nëntokës së qytetit të Durrësit.
- c) U la detyrë specialistëve të IMK, të përgatitet në mënyrë profesionale materiali i oponencës së studimit të qendrës të qytetit të Durrësit.
- d) Lidhur me 3 sheshet e ndërtimit në qytetin e Durrësit:
 - Të mos lejohet ndërtimi në sheshin ku kryen gërmimet firma "Fakle", zona arkeologjike A sipas zonifikimit të qytetit të Durrësit, VKM Nr. 6, dt. 07.01.2005, pranë Bashkisë Durrës. Të ruhen zbulimet e dala nga gërmimet.
 - Të mos lejohet ndërtimi në sheshin e Kullës tre këndore, ku kryen gërmimet firma "G&XH" sh.p.k., Lagja nr. 6, rruga "H. Mushketa". Të ruhen zbulimet e dala nga gërmimet.

Për të dy rastet e mësipërme pritet propozimi i IA, për shpalljen e zbulimeve Monument Kulture.

- Të ruhen zbulimet arkeologjike të dala në nekropolin e qytetit antik, në lagjen nr.1, rruga "A. Durrsaku", në hapësirën muzeale të integruar në ndërtimin e ri, mbi bazën e një projekti të ri të themeleve. Projekti i ri duhet të marrë miratimin e Këshillit Shkencor të IMK si dhe atë të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

Miratimin e projekteve:

1. Restaurimi i Godinës Muzeu i Pavarësisë, Vlorë.
2. Kabinë informacioni dhe ambiente sanitare në Kalanë e Shkodrës.
3. Ndërhyrjet sistemuese që do të realizohen në hapësirat e qytetit anik të Orikut, Vlorë.
4. Shtesë kati në banesën e Viktor Cingo, në zonën tampon, Berat.

Nuk u miratuan projektet

1. Projekt Rikonstruksioni banesa Edri Kreka, Korçë.
2. Projekt shtesë banese, pronar Liljana Pavliqi, Korçë.

IV. U miratua propozimi për shpalljen monument kulture historik:

- Burgu Politik i Spaçit, Mirditë

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
PROF. DR. YLLI PANGO

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO